



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD**

---

**GJS-2025-002**

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës – Fejzullah Rexhepi, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala N.H., kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë, M.K., më datë 13.02.2025, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET SI E PABAZUAR, ankesa e palës N.H., kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë, M.K..

**A r s y e t i m**

Në Gjykatën Supreme më datë 14 janar 2024 përmes Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, është pranuar ankesën e palës N.H., kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë, M.K., për shqyrtim të pretendimeve tek Kryetari i Gjykatës Supreme si Autoritet Kompetent, konform nenit 9 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Pala ankuese, ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë, M.K., ka paraqitur ankesën e tij me pretendimet se gjyqtari i rastit nuk cakton lëndët e tij gjyqësore me numër C.nr. 2860/21 që pesë (5) vjet, dhe lëndën 1680/22 që tri (3) vjet, tutje pretendon se çdo padi të tij e ka përfunduar, dhe e ka refuzuar. Po ashtu, në ankesën e tij, shton se në vitin 2024 ka paraqitur para gjykatës padi për pengim posedim dhe se gjyqtari nuk cakton seanca lidhur me këtë çështje.

Lidhur me pretendimet e palës, kryetari i Gjykatës Supreme, si autoriteti kompetent ka analizuar dhe shqyrtuar deklaratën e gjyqtarit M.K., lidhur me këtë rast.

Në deklaratën e tij, gjyqtari K. ka deklaruar se për shkak se nuk qëndron pretendimi i palës kjo për arsye se lidhur me lëndët e cekura në kërkesën e tij janë caktuar seanca dhe janë ndërmarrë veprime ligjore, fillimisht në drejtim të plotësimit të kërkesëpadisë dhe plotësimit të prezumimeve procedurale, çka vërtetohet edhe nga shikimi i dosjes. Tutje, në deklaratën e tij, gjyqtari ka theksuar se ka parashtruar kërkesë për përjashtim nga trajtimi i këtyre lëndëve dhe se të njëjtat janë proceduar në Gjykatën e Apelit, dhe se të njëjtat janë kthyer gjatë muajit prill dhe maj të vitit 2024, e të cilat pas kthimit nga Gjykata e Apelit janë duke u trajtuar sipas radhës. Ndërsa sa i përket lëndës C.nr. 276/24 e dorëzuar në gjykatë më 03.09.2024, lidhur me këtë janë ndërmarr veprime procedurale të cilat gjenden në shkresa të lëndës. Gjyqtari në deklaratën e tij, ka shtuar se pretendimet e palës janë të paargumentuara dhe të pambështetura në prova konkrete.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklaratës së gjyqtarit, si dhe provave të cilat ia ka bashkëngjitur deklaratës, vlerësoi se:

#### **Ankesa është e pabazuar.**

Pas shqyrtimit të ankesës së palës N.H. dhe të deklaratës së gjyqtarit M.K., si dhe analizimit të provave të paraqitura, vlerësoj se ankesa e palës është e pabazuar dhe nuk ka asnjë mbështetje në fakte apo prova.

Pala ankuese ka ngritur pretendime ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë, M.K., për neglizhencë dhe mos caktim të seancave për lëndën e tij gjyqësore, si dhe për refuzim të shqyrtimit të padive të tij. Megjithatë, këto pretendime nuk janë mbështetur me prova konkrete, që do të vërtetonin shkelje të ligjit nga ana e gjyqtarit. Nga deklarata e gjyqtarit dhe shkresave të lëndës rezulton se janë ndërmarrë veprime procedurale në lëndët gjyqësore të palës ankuese në këtë rast, dhe se pretendimet e palës janë të paargumentuara dhe të pambështetura në prova konkrete.

Prandaj, vlerësoj se në këtë rast, ankesa është dukshëm e pabazuar dhe jo serioze dhe e njëjta nuk përmban një përshkrim të qartë dhe të saktë të aspekteve faktike dhe juridike që mbështesin pretendimet për shkelje disiplinore të kryera nga gjyqtari i çështjes.

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mënyrë shprehimore në nenin 5, ka paraparë rastet në të cilat konsiderohet se është kryer shkelje disiplinore, në rastin konkret rezulton se veprimet e gjyqtarit M.K., nuk kanë konsumuar ndonjë nga shkeljet e parapara me këtë Ligj.

Andaj, për shkak se në parashtrësën e palës, nuk potencohet ndonjë shkelje konkrete e paraparë në Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

**Fejzullah Rexhepi**  
**Kryetar i Gjykatës Supreme**

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Gjyqtarit,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.